

Two anniversaries

Abstract: *Focusing on the 550 anniversary of the death of the Albanian National Hero Gjergj Kastrioti Skënderbeu and on the 770 anniversary of the settling of the Franciscan order in Albania (1248), the essay highlights the invaluable contribute of the Franciscans to the preservation of cultural and national values of the Albanians. The settling of the Franciscans in the Albanian territories occurred when helenisation and slavisation had gain momentum the author believes.*

When the Ottomans appeared in the Balkan Peninsula in an attempt to overrun Albania and reach Italy, the Franciscans never stopped working for the defence of the Cristian faith. In fact, their aid to Gjergj Kastrioti Skënderbeu in his activity and struggle against the Turks is widely acknowledged. Some of the Franciscan friars would be emissaries of Skanderbeg to the European courts, others would even exhort or participate in the battles of the Albanians against the Ottomans.

Keywords: *Franciscans, National identity, Slavisation, Helenisation, the Ottoman conquest, Balcan, Scanderbeg.*

Ngaqë mbarë shqiptaria po përkujton sivjet 550-vjetorin e Heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeu, “i cili ishte prodhimi më hyjnuer i racës shqiptare”¹; dëshiroj të sjellë në mendjen e lexuesit edhe një tjetër përvjetor fort të rëndësishëm për kulturën mbarë shqiptare. Përvjetori në fjalë ka të bëjë me vitin e shtatëqind e shtatëdhjetë të pranisë françeskane në trojet tona, të cilët skalitën me shkronja të arta, epopenë e lumnueshme, të binomit “Fë e Atdhé” në trojet Arbnore, dhe të cilit i qëndruan besnik, që prej mbërritjes së tyre në këto troje. «Herë mbas heret petku i tij i murrte u ngiye me gjak. Me këtë gjak frati shqiptar i bëni shtrojën shkabës së zezë. Me jetë e me dekë forcoi përsá i përkitëte atij - e ma tepër se i përkitëte - flamurin e lirisë. Frati shqiptar i bëni vetit një program veprimi, program që për të vorrin e bën të kandshëm e dekën të ambël. U rrit, u edukue e jetoi për Fë e atdhë»². Françeskanët e deshtën gjithmonë Shqipërinë, dhe Shqiptarët, i deshtën pa kurrfarë interesi, asnjë herë nuk pretenduan

1 M. SHUFLAJ, *Serbët dhe Shqiptarët*, Tiranë 1926 f. 195.

2 D. GJEÇAJ, *Shkrime historike, letrare publicistike*, Vepra, I, Shkodër 2012, f. 31.

shpërblime; por as nuk u penduan për atë që bënë, sepse ishin të dashuruar me popullin e këtyre trojeve, të dashuruar me thjeshtësinë, bujarinë, besnikërinë dhe trimërinë e tyre. Fatet e popullit tonë përgjatë historisë, françeskanët vërtet i patën fort për zemër. Kjo dashuri e përzemërt që patën për popullin tonë, françeskanëve u kushtoi shumë mund, sakrificë, shumë gjak. «... frati varej në konop, ngulej për së gjalli në huj si berri i ferlikut në hëll; rrëzohej prej shpate e plumbi, strukej ndër shpella e pyje, por grigjën e vet s’e lënte, tokën e Shqipnisë s’e braktiste».³

Qëllimi i këtij studimi është që në këtë përvjetor të Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skandërbeu, të përshkruaj shkurtimisht edhe përvjetorin e 770^{-të}, të françeskanizmit në trojet Arbnore.

I. Kronologji e shkurtër mbi praninë e françeskanëve në trojet Arbnore

Në faqet e para të “Nekrologut të Provincës Françeskane Shqiptare “Zoja Nunciatë”⁴ gjejmë një kronologji të shkurtër historike mbi françeskanizmin në trojet tona. Në këtë paraqitet se, themeluesi i françeskanëve Shën Françesku i Asizit, (për këtë mendim nuk ka fakte por vetëm legjendë), duke u kthyer nga Egjipti, ndaloi në Lezhë dhe themeloi, Misionin françeskan në trojet tona⁵. Bëhet fjalë për vitin 1219, por në fakt, deri tani nuk ekzistojnë burime historike që e dëshmojnë një gjë të tillë. Ndërsa legjenda thotë se i Lumi Atë Françesku duke u kthyer nga lindja, ndaloi në Lezhë, vend prej të cilit shkëputi edhe një degëz pishë, të cilën e mbolli në Venedik, në ishullin e quajtur: *S. Francesco del Deserto* (1219). Degëza e mbjellur lëshoi rrënjë dhe u bë një pemë e madhe, dhe qëndroi deri në vitin 1702. Po ashtu në këtë përshkrim të shkurtër paraqitet edhe një fakt tjetër pak a shumë i kësaj natyre, në ballin e derës kryesore të kishës së “Zojës Nunciatë” në Lezhë gjendej e shkruar: «HOC TEMPLUM FRATRUM MINORUM AEDIFICATUM EST ANNO MCCXL», (Ky është Tempulli i Fretërve Minorë, i ndërtuar në vitin 1240). Ky shkrim, ndodhej në ballin e kishës, në traun e derës kryesore, mbas mbylljes së kishave gjatë komunizmit (1967), u hoq nga balli i kishës dhe qe transportuar në muzeun e Lezhës në vitin 1970⁶.

3 D. GJEÇAJ, *Shkrime historike*, Shkodër 2012, f. 33.

4 URDHRI I FRETËRVE MINORË, *Nekrologu i Provincës Shqiptare të Zojës Nunciatë*, Shkodër 2001, f. 3-5.

5 D. DE GUBERNATIS, *Orbis Seraphicus, de Missionibus Apostolicis Fratrum Minorum ad infideles a Sacra Congregatione de Propaganda Fide dependentibus*, Tomus II, Quaracchi 1886, f. 414.

6 Në lidhje me epigrafin e ballit të kishës në fjale shih edhe: G. HOXHA-L. PËRZHITA-F. CAVALLINI, *Monumente Historike të kultit të Krishterë në Dioqezën e Lezhës*, Lezhë 2017, f. 41-46.

Në vitin 1995 disa pjesë të tij u gjetën dhe ruhen në kuvendin e Lezhës⁷. «Edhe një gjë tjetër është për t'u vënë re. Kisha në fjalë ka ket inskripcion në ball, mbi derë: "Hoc tem plum Frat. Minor. ædificatum est anno MCC40". Po të kishte se si nieri me mbledhë provë të mjaftueshme për autenticitetin e këtij inskripcioni, me vjetërsin e kësaj ndertese kishte me u sigurue edhe të venduemt e Françeskanëve në at qytet qësh ndër kohët e para të jetës françeskane, por ky pa dyshim është më i vonshëm se ka datën. Me këta nuk duem me thanë se jemi të njëj mendimi me ndonji shkrimtar të sotëm, për të cilin ky inskripcion jo veç se është apokrif, por se edhe i ven duem tash së vonit prej ndonji frati me qellim kinsë të provojë vjetërsin e asaj ndertese»⁸. Sigurisht për t'u besuar më tepër se këto që folëm më sipër, (në lidhje me mbërritjen e françeskanëve në trojet tona), është informacioni që e gjejmë në dorëshkrimin e quajtur "Registro della Provincia osservante d'Albania, 1720"⁹, që thotë se në Durrës në vitin 1240, gjendeshin dy kuvende rregulltarësh, njëri i domenikanëve dhe tjetri i françeskanëve, prej të cilëve dolën shumë pinjollë mendjendritur që punuan për fe e atdhe¹⁰.

a. Burime të sakta historike

Ndërsa të dhënat që kanë burime historike të sakta, për ardhjen e françeskanëve në trojet tona janë të lidhura ngushtë me ardhjen e fra Giovanni da Pian del Carpine, i cili në vitin 1248 u emërua Arqipeshkëv i Tivarit¹¹. «Për me vënë re për fije dishiplinen kishtarë të lanun qësh kur mbas dore, e me i vënë një pritë të qindrueshme të prishunit të zakonevet të krishtëna lypej një dorë e fortë, e këtë e gjeti papa Inocenci IV në françeskanin Giovani de Plano Carpine, të cilin në vjetën 1248 e shënjojte për Selin metropolitane

7 «N'ato pak dit, qi i tokoi ketij me ndëjë n'at qytet, me jeten shëjte të veten bënë për vedi zëmrat e shumkuj, e ndër tjerë të famullitarit t'atij qyteti, të një farë Dom Lleshit, i cili veshi petkun e pendesës shi prej duervet të Shëjtit. Me lëmoshë mandej, qi ky mbledhi ndër bënë mirsa, ndërtoi më vonë një kuvend e një Kishë po në vend e mbas shëjvet qi i pat caktue vetë Shëjti me një shkop pishet, qi muer me vedi si kujtim në Venedik. [...]. Se që randsi mundet me pasë kjo legjendë na nuk po shprehemi, veç sa për kureshti t'atyne të cilvet u vesket me gjetë ndonji rrëfandë a grrëmç me bënë kerkime të reja historike, po u a qesim ndër mend, se edhe mbas sa shekujsh qi vijimisht i sherbejn Françeskant atij vendi shëjt, populli gjithnjë e quën "Kisha e Dom Lleshit", si edhe legjenda mbi shkopin e pishës, qi permendem sypr, është edhe sot e gjallë në Venedik (Deserto)» M. SIRDANI, *Kontributi i elementit katolik shqiptar*, Prishtinë 2002, f. 12.

8 M. SIRDANI, *Kontributi i elementit katolik shqiptar*, Prishtinë 2002, f. 14.

9 L. DELLA CROCE, *Registro della Provincia osservante d'Albania, 1720*, (regjistri i Provincës oservante të Shqipërisë) f. 265.

10 P. V. MALAJ, *Te dhana Albanologjike, Folklor, Bibliografi, Histori, (Dati Albanologjic, Folclor, Bibliografie, Storia)*, në «Shoqata Gjon Buzuku», Vol. II, Ulqin-Tuz 1999, f. 315.

11 L. THALLÓCZY-C. JIREČEK-M. [DE] ŠUFFLAY, *Acta et diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia II* (1344-1406), Vienna 1913-1918, (rist. anast., a cura di S. SINANI-M. AHMETI, Tirana-Prishtina 2002, n. 191.

të Tivarit»¹² Po ashtu vetëm dhjetë vjet më vonë (1258), papa Aleksandri IV (1199-1261), ia porositë Fretërit Minorë kryepeshkvit II-të të Tivarit Lorenzo da Orta: (1253-1255), me qëllim që t'i mbronte nga kthetrat e keqbërësve. Mandej, Fra Girolamo da Ascoli, qe emëruar nga papë Nikolla IV (1227-1292), si ministër provincial i Dalmacisë prej së cilës varej Misioni Shqiptar (1260-1270). Ndërsa, në vitin 1283 rezulton se kuvendet e Tivarit, Durrësit dhe Ulqinit i përkisnin Kustodies së Dubrovnikut në Provincën e Dalmacisë¹³. Këto kuvende janë banesat e para të mirëfillta të françeskanëve në trojet Arbnore. Po ashtu, njihet edhe testamenti i vitit 1283 në të cilin emërohen si kuvende të Kustodies së Dubrovnikut, kuvendet e Kotorit, Tivarit, Ulqinit dhe Durrësit. Ndërsa në vitin 1288 qenë ndërtuar kuvendet e Shën Marisë në Shkodër, i Shën Françeskut në Tivar dhe i Shën Marisë në Ulqin¹⁴; nga Mbretëreshë Helena e Serbisë (1236-1314), që ua dhuroi françeskanëve, si kishën, po ashtu edhe kuvendin e Shën Marisë në Shkodër, si dhe kuvendin e Shën Markut në Ulqin. Dhe Në vitet 1280-1307 mbretëreshë Helena bëri të mundur edhe që në rrethinat e Tivarit të ndërtohej një kuvend i Shën Françeskut¹⁴. Sipas burimeve historike dihet se që prej vitit 1291 deri në vitin 1402 Kustodies së Dubrovnikut¹⁵ i përkisnin kuvendet e Durrësit, Shkodrës, Tivarit dhe Ulqinit¹⁶.

12 M. SIRDANI, *Kontributi i elementit katolik shqyptar*, Prishtinë 2002, f. 17.

13 D. GJEÇAJ, *Shkrime historike*, Shkodër 2012, f. 26-30.

14 «Shekulli në të cilin gjindemi tashti, dmth. shekulli XIV, përbën kohën e artë të Françeskanizmit në vendin tonë. Vertetohet që ma se 37 qendra ishin vendbanime të Françeskanëve e se Fretënt në këtë shekull ishin aq shumë me numër, sa me mbushë me françeskanë shqiptarë deri kuvendet e nevojët e Raguzës e të Dalmacisë. Mjafton me përmendë se në kohën e murtajës, rreth vjetit 1396, Guardiani i kuvendit të Raguzës e vetë kustodi i kësaj kustodie kjenë nga Shkodra, ashtu si i shkodrën kje dhe Guardiani i Zarës. Kah mbarimi i shekullit XIII përmendet Fra Deda nga Shqipnia (Domenicus Albanensis) i cili, tue pasë kenë gjâ me gjak me shumë princa të krahinave të mjesme të shqipnisë dhe tue pasë fitue nám e emën të madh për zotsí e dije, ishte i ngarkuem nga Selia shenjte e Romës, dhe në këtë drejtim veproji me sukses, për të kthye nga ortodoksia shumë princa e për të mbajtë besnikë të Romës tjerët, që shikojshin me simpatí nga Konstandinopoja. Në vjetin 1395 përmendet Fra Nikolla nga Samërisi (Nicolaus de Samarixi) i Shkodrës, profesor fort i ndritun i teologjisë e posi i tillë, i dërguem nga Gjergji I Balsha bashkë me dy vëllazën të tjerë fretën, për t'ia dorëzue Venedikut dy qytetet e Shkodrës e të Drishtit asaj republike, me shpresë se kështu do të pështoheshin nga kërcnimet turke. Kur kështjelli i Shkodrës, Rozafati, në vjetin 1405 kje rrethue nga urditë turke, një françeskan shqiptar, Pater Françesku nga Shkodra, mbroi qytetzën dhe kështjellin nga forcat otomane dhe me trimninë e vet e me armë në dorë, e libroi nga rrethimi» (D. GJEÇAJ, *Shkrime historike*, Shkodër 2012, f. 29).

15 D. FABIANICH, *Storia dei frati minori dai primordi della loro istituzione in Dalmacia e Bossina*, Vol. II, Zara 1863 f. 337.

16 «Ndertimin e këtyne kuvendeve kush i a pështetë Helenës së shoqes së Shtjefen Uroshit I (1280-1307), kush së motrës së saj, Maris de Chau, e cila per shum vjet jetoi n' Ulqin, e aty vdiq e u vorrue» (M. SIRDANI, *Françeskanët në Shqypni*, Prishtinë 2002, f. 25).

Ndërsa, në vitin 1402 u formua Kustodia e Durrësit e ndarë nga ajo e Dubrovnikut. Dhe në vitin 1484 Kustodia e Durrësit qe emëruar si Provinca e Maqedonisë¹⁷. Ndërsa në vitin 1585, Provinca e Maqedonisë, mori emrin Kustodia e Shqipërisë (Custodia Albanense). Dhe në vitin 1592, Kustodia e Shqipërisë u shpall Provincë me të gjitha të drejtat e plota¹⁸. Po ashtu, me datën 23 Korrik në vitin 1634 qe themeluar Misioni i Fretërve Minorë të Reformuar¹⁹. Ky Mision ishte ndarë në katër Prefektura Apostolike: Kastrat, Pult, Maqedoni dhe Serbi (duke përfshirë dhe trojet e Dardanisë, Kosovës). Po ashtu me dt. 9 tetor 1832 me breve të papës Gregorit XVI (1765-1846) “Felicis recordationis”, Provinca qe transformuar në Mision Apostolik, dhe katër Prefekturave u qe shtuar edhe ajo e Epirit. Që prej 31 janari 1898, e deri më 23 Prill 1906 Provinca qe drejtuar nga një Komisar gjeneral “Provincialis ad instar”. Ndërsa me dt. 23 Prill 1906 Selia Apostolike ripërtërin Provincën me titullin e vjetër “Zoja Nunciatë”; kur si ministër gjeneral qe fra Dionis Schuler (1903-1911), me lejen e veçantë që iu dha prej Selisë së Shenjtë më 23 prill 1906, më 5 shkurt të vitit 1920²⁰ e ringriti edhe një herë “Provincën Misionare Françeskane Shqyptare” duke ia ruajtur edhe titullin që kishte pasur më parë “Zoja Nunciatë”²¹. Si ministër provincial i provincës së rindërtuar qe fra Lorenc Mihačević, i cili me urti e zell i vuri themelet e provincës së re, edhe pse mjerisht në vitin 1912 prej ministrit gjeneral fra Pacifico Monza (1911-1915), “Provinca Misionare Françeskane Shqyptare” porsa kryen tri vjetët e provincialatit të dytë të fra Luigi Paolucci, sërish u kthye si komisar, dhe në krye u

17 «Thonë veç se kuvendet e naltpermenduna shkuen qýsh se xún fill e djeri në vjeten 1402 me Kustodin e Raguzës 243 e atëherë u ngrehen Kustodi në vedi me ëmen “Custodia Dyrachina”, në sa kuvendet e ndertueme në mbrendmení trajtuen një provincë të pamvarshme të quejtun “Provincia Macedoniæ” 244, me të cillen u bashkuen edhe ato të Kustodís së Dursit në vjeten 1484. Se kur kjenë dá prej Provincës së Romanís a të Greqís me të cillen shkuen n’e parë e bâ Provincë në vedi nuk dihet me siguri» (M. SIRDANI, *Françeskanët në Shqypni*, Prishtinë 2002, f. 26).

18 F. GONZAGA, *De origine seraphicae religionis franciscanae*, Rome 1587, f. 548.

19 Sipas informacionit që e gjejmë të renditur fort mirë në Veprën “Illiricum Sacrum” aty ku flitet për ipeshkvin e Sapës Gjergj Bardhin, na jepen edhe emrat e dy Fretërve të parë Oservantë që mbrrijnë në tokën tonë, emrat e të cilëve janë fra Bonaventura de Palazolo prej Breshës e fra Kerubini prej Trentos; (D. FARLATI-I. COLETI, *Illyrici Sacri, Ecclesia Diocletana*, t. VII, Venetiis 1817, f. 284. Informacione më të zgjeruara për ardhjen e fretërve oservant në trojet Arbnore i gjejmë edhe në përmbledhjen e memorieve historike të provincës së reformuar të Romës. (P.B. SPILA, *Memorie storiche, della Provincia Riformata Romana*, Tomo II, Milano 1896, f. 302-303).

20 Kjo datë ndryshon sipas të thënave që i gjejmë në “Schizzo storico sull’opera dei Francescani in Albania”. Në fakt të dhënat për ngjarjen në fjalë, paraqiten me dt. “5 qershor të vitit 1919” (FONDO, *Schizzo storico sull’opera dei Francescani in Albania: (Pro Manuscripto)*, Scutari 1930, f. 3. (deposito, MISC. 0218 (01).

21 FONDO, *Schizzo storico*, f. 8-9.

emërua fra Domenic Facini²². Mbas fra Domenikut ministër i “Provincës Misionare Françeskane Shqiptare” bëhet fra Palë Dodaj (1880-1951, në vitin 1920). Me këtë njeri fort të devotshëm e të dijshëm fillon një faqe e re për historinë e dhimbshme të françeskanëve në Shqipëri. Në një kohë krejt të shkurtër filluan një larmi iniciativash në fushën fetare, kulturore e kombëtare, të cilat më së miri na i përshkruan fra Donat Kurti në librin me titull “Provinca Françeskane Shqiptare”²³. Mjerisht, këtij zhvillimi që sollën gjigandët e françeskanizmit shqiptar, iu zu fryma prej resë së zezë të komunizmit që erdhi e u ul këmbëkryq si dreq i zi në mbarë vendin tonë, duke ua shpërblyer françeskanëve të mirat e panumërta, me torturat më çnjerëzore. Sërish këta gjigandë u gjetën nën peshën e kryqit të hekurt, që sistemi i pafe e i pa njerëzi ngarkoi mbi shpatullat e pafajshme të tyre vetëm e vetëm se ishin dishepuj të denjë të Krishtit e ndjekës të Shën Françeskut. Me qëndresën e tyre nderuan Kishën, Urdhrin dhe Vending tonë. Në fakt, vuajtjet, djersa e gjaku i tyre që nuk e kursyen deri në pikën e fundit, të lidhur ngushtë vetëm me pushtetin e Krishtit mbret, dhe thirrën deri në frymën e fundit duke lëvdur “Rrnoft Krishti Mbret!” e “Rrnoft Shqypnia!” Në mars të vitit 1967, qeveria komuniste mbylli të gjitha kishat e Shqipërisë. Me këtë akt pushoi çdo formë e hapur e jetës së Provincës sonë. Provinciali i fundit që fra Augustin Ashiku i zgjedhur me datën 3 korrik 1961.

Në fundin e vitit 1990 populli shqiptar rihapi kishat. Dhjetë Fretërit tanë të mbetur në Shqipëri rimorën shërbimin nëpër famulli. Në dhjetor 1991 ministri gjeneral, fra Hermann Schalück (1939-2008), emëron fra Gianmaria Polidoro si delegat gjeneral për Provincën Shqiptare. Me 17 mars 1995, gjatë Kapitullit të parë, vetë ministri gjeneral shpalli udhëheqjen “ad instar regularis” ku si ministër provincial u emërua fra Flavio Cavallini, i cili e mbajti këtë detyrë deri në vitin 2004. Ndërsa fra Ndue Gashi u zgjodh si ministër provincial në vitin 2004-2006. Mandej, si ministër provincial vazhdoi fra Gazmend Tinaj në vitet 2006-2014. Me dekretin e datës 14 nëntor, ministri gjeneral fra Michael A. Perry e shndërroi Provincën në Kustodie të varur nga ministri gjeneral, dhe si kustod emëroi fra Aurel Gjerkanj, i cili e mbajti këtë detyrë edhe mbas zgjedhjeve të kapitullit të fundit (29 janar - dt. 4 shkurt të vitit 2018).

II. Ardhja e Françeskanëve në trojet Arbnore dhe Gjendja politiko-sociale e shekullit XIII.

Nuk janë të paktë studiuesit që ardhjen e Françeskanëve në trojet Arbnore e lidhin me themeluesin e këtij Urdhri, Shën Françeskun e Asizit, (1181-1226), në kohën kur po kthehej prej Sirisë²⁴. Padre Sirdani i cili

22 D. KURTI, *Provinca*, f. 48.

23 *Ibidem*, f. 56; edhe f. 155-273.

24 M. SIRDANI, *Të venduemt e Françeskanëve neper vise të ndryshme të Shqypnis - 1240-*

gëzon një autoritet të spikatur në fushën e historisë së françeskanizmit në trojet tona thotë se: «Historjakët e Urdhnit françeskan: Wadding, Gonzaga, De Gubernatis, Civezza, Fabianich, Holzapfel etj. janë të gjithë të mendimit, se Françeskant xûn vend në Shqypni qýsh në kohët e para t' Urdhnit. Ky i mbрами, Holzapfel, thotë se "së pakut u gjindshin këtu në vjeten 1240»²⁵.

Por në fakt, burime të sakta historike (të njohura deri tani), të pranisë së françeskanëve në Shqipëri shënohen vetëm në vitin 1248²⁶, në kohën kur ja mbërriti një bashkëkohës i vetë Shën Françeskut, fra Giovanni dal Pian del Carpine²⁷, (1180-1252)²⁸, i cili qe emëruar prej papës Inocenci IV (1195-

1940, në «Hylli i Dritës», n. 1-2, (1940), f. 65-83.

25 M. SIRDANI, *Të venduemt e Françeskanëve*, në «Hylli i Dritës», n. 1-2, (1940), f. 71.

26 A. FISHTA, *Ma i pari Frat në Shqypni. Ëmzot Gjoni prej Plano Karpini*, në «Hylli i Dritës», n. 4, (1930), f. 209-217.

27 «Ky Prelat bëni që të vijshin në Shqipni Françeskanët dhe domenikanët tue zavendësue kështu benediktinët, të cilët që nga kjo kohë kishin nisë të braktisshin një pjesë të manastireve të tyne. Me nismën e Arqipeshkvit të palodhun të Gjonit nga Pian Karpino dhe mbasardhësve të tijë në selinë e Tivarit si Guffridi me 1253, Fra Lorenci në 1255, Fra Martini 1304 dhe të tjerë në selitë e ndryshme ipeshkvnore dhe arqipeshkvnore të Shqipnisë si Fra Pjetri nga Tiburi, ipeshkv i Sarandës me 1260, Fra Bonaventura, ish ministër i përgjithshëm i Urdhnit në selinë e Arbnit me 1273, Fra Antonin nga Durrësi me 1303 dhe shumë të tjerë, thirrën frëtnit e Urdhnit të tyne për me i ndihmue ata në veprimtarinë misionare. Kështu, mbrenda një kohe të shkurtë, ata zûnë vend në vise të ndryshme të Shqipnisë» (V. MALAJ, *Kuvendi i Arbnit 1703*, Tuz 2017, f. 107).

28 Informacionet e para i gjejmë, në librin e „Kronikave” te Xhordanit prej Gianos, të redaktuara mbas vitit 1262. Sipas Tomës prej Çelanos, (në të ashtuquejtunën *Vita prima beati Francisci*), Giovanni duket se qe pjesë e grupit të atyre njerëzve të ditur që hynë të rritur në vazhden e ndjekësve të Shën Françeskut të Asizit rreth vitit 1215. Informacione të tjera mbi këtë figurë i gjejmë, edhe me rastin e kanonizimit të Françeskut (1228). Po ashtu dihet se prej Giovanni Parenti-t (1180-1250) ministrit gjeneral të Urdhrit françeskan, qe emëruar ministër provincial për Gjermaninë, ku vetëm mbas dy viteve (1230), qe transferuar në Spanjë, e ku qëndroi vetëm dy vjet dhe rikthehet sërish (1232), si ministër i provincës së re të Saksonisë, detyrë që e mbajti deri në vitin 1239. Në vitin 1245, u ngarkua prej papës Inocenci IV (1195-1254) të shkojë pranë Mbretit Khan të Mongolëve, që në atë periudhë pat qenë Güyük Khan (1206-1248), i nipi i të fuqishmit Gengis Khan (1162-1227), të cilin Giovanni e takoi shumë herë. Pikërisht këtij mbreti Giovanni i dorëzoi letrën papnore *Cum non solum homines* (Lion, 13 mars 1245). Në letër, Papa fton Mongolët ta ndalin pushtimin në krahinat e Europës qendrore, dhe të bëhet një marrëveshje paqeje me krishterimin. Giovanni dal Pian del Carpine, iu besua në të njëjtën kohë të përcillte edhe një letër tjetër, në prag të koncilit të parë të Lionit (1245), *Cum simus super*, që papa ua drejtonte patriarkëve, Arqipeshkvive dhe ipeshkvive të bashkësive të krishtera të Lindjes për t'u bashkuar me kishën e Romës, në prag të koncilit të Lionit. Mbas këtyre misionëve shumë të rëndësishme që i kreu në Lindje, të cilat vetë ai na i përshkruan edhe në *Historia Mongalorum*, pati edhe detyra të tjera të ndryshme, si brenda Urdhrit ashtu brenda Kuries Romake. Më në fund vjen ajo që ne na intereson më shumë, në vitin 1248 emërohet Arqipeshkvë i Tivarit, të cilit më së pari i takoi të gjejë zgjidhje për konfliktin e komplikuar Juridiksional mes Dioqezës së Tivarit dhe Dioqezës së Raguzës (Dubrovnikut). Për informacione më të gjera për këtë mendje të ndritur mund të shikohen: G. SORANZO, *Il Papato, l'Europa cristiana*

1254), si Arqipeshkëv i Tivarit. Kjo figurë e ndritur françeskane luajti një rol të pazëvendësueshëm, qoftë për krishterimin Latin, qoftë për etninë e Arbnit, në gjysmën e parë të shekullit XIII. Françeskanët mbasi mbërritën në vendin tonë, erdhën gjithnjë e më tepër duke u rritur në numër dhe mbasi u stabilizuan në trojet e Arbnit, nuk i braktisën për asnjë moment trojet tona²⁹.

Situata politiko-fetare e shekullit XIII e trojeve Arbnore, gjendej përballë një rrezikshmërie të thekshme të Sllavizmit e të Bizantinizmit³⁰. Po ashtu duhet të kujtojmë se të njëjtën situatë që po përballonte populli i trojeve të Arbnit, po e vuante edhe Krishterimi Latin, i cili përveçse gjendej nga ana e jashtme përballë rrezikut të sllavizmit e bizantinizmit, në brendësinë e vet vuante prej konfliktit tejet të zgjatur mes dioqezës së Raguzës (Dubrovnikut) dhe Dioqezës së Tivarit. Për ta kuptuar në mënyrë sa më të plotë rrezikshmërinë e sllavizmit dhe të bizantinizmit në

e i Tartari. Un secolo di penetrazione occidentale in Asia, Milano 1930, p. 77-113; C. SCHMITT, *L'epopea francescana nell'impero mongolo nei secoli XIII-XIV*, in «Venezia e l'Oriente. Atti del XXV Corso internazionale di alta cultura», Firenze 1987, p. 370-408; M. DA CIVEZZA, *Storia universale delle missioni francescane*, Tomo I, Roma 1857, p. 303-347; F. LIVERANI, *Fra G. da Pian di Carpine del contado di Magione viaggiatore e descrittore di Tartaria e Mongolia nel secolo XIII*, Perugia 1876.

29 «Duket se per do kohë, si në disa vise tjera ngjeti, Françeskant, ku mâ shumë e ku mâ pak, edhe në Shqypni, banuen nder shpija private të lshueme prej bâmirsavet, e mandej, tue pa nevojtë e vendit, e tue vû oroe shpresen qi populli shqyptâr shkojte tue shtue ndaj ta, u dhân, në rrymen e vjetvet, me u kujdesë neper bâmirsas për me ndertue kuvende e kisha për vedi. [...] Mâ i vjetri dokument qi është diktue deri më sot është ai i vjetës 1283, kû në një legat permenden banimet e Françeskanëve në Katorr, Tivâr, Ulqin e Durrës: "Desa uxor condam Tollisclau de Pracouizio... cuilibet loco fratum Minorum custodie Ragusine videlicet Catari Antibari, Ulcinii et Dyrachii, hyperpera tria legat". Gjithnji në një testamend me datë 18 Kallënduer 1284 due me thanë një vjetë mbas, permenden banimet e Françeskanëve të çekuna sypr, e për setcilin banim lidhen ka pesë perpera "perperi quinque pro quolibet loco". Me kaq vertetohet historikisht se në vjetin 1283-1284, Françeskant ishin të venduem në Katorr, Tivâr, Ulqin e Durrës. Pak vjet mbrapa, 1288, Helena, mbretnesha e Serbis, të cilën e kemi çekë edhe parandej, së bashkut me të motren, Marin de Chau, ndertuen për Françeskan kishën e kuvendin e Shen Mëris në Shkoder e kuvendin e Shen Markut në Ulqin. [...] Ndertimin e këtyne kuvendeve kush i a pëstetë Helenës së shoqes së Shtjefen Uroshit I (1280-1307), kush së motrës së saj, Maris de Chau, e cila për shumë vjet jetoi në Ulqin, e aty vdiq e u vorruë" M. SIRDANI, *Të venduemt e Françeskanëve neper vise të ndryshme të Shqypnisë - 1240-1940*, në «Hylli i Dritës», n. 1-2, (1940), f.73-74.

30 «Prandaj, as sundimi i gjatë Bizantin nuk i siguroi Shqipnisë një periudhë paqje. për ma tepër, ndoqi një periudhë e gjatë luftash të papajteshme dhe të rrepta që lanë gjurmë të pashlyeshme në zhvillimin e shoqërisë shqiptare. Perandorija e Lindjes u detyruë me luftue kundër sllave dhe bullgarë dhe kundër shteteve normane - italiane që pushtuene pastaj bregdetin. Ankthi politik në ndryshimin e vazhdueshëm të padronëve dhe atij fetarë midis Romës e Bizantit në shekujt e mavonshëm si dhe copzimit të Shqipnisë midis serbëve dhe Bullgarëve, iu shtuen, mbas vjetve njimijë, pushtimet normane dhe veneciane për Zotnimin e vendit tonë» (V. MALAJ, *Kuvendi i Arbnit*, f. 89).

trojet Arbnore³¹ po thërrasim në ndihmë eruditin tonë, patër Sirdanin, i cili na thotë se: «Kështu ishte gjëja e Shqypnisë në kohën kurë u venduen Françeskanët në dhén t'anë. Prá, si shihet, historia e shekullit XIII na e paraqet katoliçizmin në Shqypni të vulluem prej slavizmit e bisantinizmit, ase me folë m'at k'jartas, prej Serbvet e prej Grekvet. E mbasi këta dy popuj e perziejshin idén "Religion" me idén "Shtet", jo vetem se ishin kundërshtarët e katoliçizmit në Shqypni por edhe të kombit shqyptár, pse me u b'at antarë të kishës serbe a greke; mbasi u d'an prej katoliçizmit, per një Shqyptár ishte njëjti si me mohue kombësin e vet e me pranue kombësin serbe a greke. E kështu njëmend edhe ndodhi zakonisht, pse shumica e madhe e Shqyptarvet q' u shkeputen prej katoliçizmit, d'jeri nder këto kohët e vona, u mbajtën a Serbë a Bullgarë a Grekë, posë njëj çete së vogël intelektualësh, a q' jetuen jashta atdheut»³².

Në fakt që të kuptohemi më mirë në lidhje me rrezikshmërinë e sllavizmit e të helenizmit, duhet shkurtimisht me e kthye shikimin tonë në mijëvjeçarin e parë të krishterimit në trojet tona. Lidhshmëria e pazgjidhshme mes krishterimit perëndimor dhe popullsisë së trojeve tona, është fort e hershme. Dëshmi e kësaj lidhje janë letrat e panumërta që papët e Romës ua dërgojnë ipeshkvijve të Ilirisë, në mënyrë të veçantë gjatë periudhës së organizimit kishtar, shekullit IV-V³³. Mund të pohoj me siguri se litari i kësaj lidhje të pazgjidhshme mes krishterimit perëndimor dhe popullsisë së trojeve tona ishin benediktinët. Rënojat e shumta të manastireve benediktine, që gjenden në trojet tona janë një dëshmi e paprekshme, dhe e pamohueshme³⁴. Në fakt në trojet tona krishterimi ishte i pranishëm në dy format e veta, ai i ritit latin dhe ai i ritit bizantin: «Si dihet, qyshë me zotnimin romak, në dhén t'anë u perdoren dy gjühë zyrtare: greqishtja e latinishtja, e kaq, sa d'jeri në kohët e mbrame para pushtimit turk, kundrohen akte latinishte me nenshkrime greqishte e anasjelltas. Prej kësajë pune ndodhí, q' qyshë u organizuen djeçezet, si gjuhë liturgjike ku perdoret greqishtja e ku latinishtja, e diku-diku të dyja. Në Shqypnin e verit, ase Prevalitanje, zotnojte riti latin; n'at të jugut, ase Epirus Vetus, riti grek; e në Shqypnin e mesme, ase Epirus Nova, ku njani a ku tjetri riti, simbas influencet m'at të madhe a m'at të vogël të Bizancit a të

31 Në mënyrë që të kuptohet sa mirë situata politiko-sociale e kësaj kohe duhet të mbahen parasysh puna shkencore e A. DUCCELLIER, *La façade maritime de l'Albanie au Moyen Age: Durazzo et Valona du XI^e au XV^e siècle*, Paris 1978; dhe e P. XHUFI, *Dilemat e Arbrit. Studime mbi Shqipërinë mesjetare*, Tiranë 2006.

32 M. SIRDANI, *Vepra atdhetare e françeskanëve*, në «Hylli i Dritës», n. 12, (1940), f. 573.

33 K. S. TARAOUCA, *Epistularum Romanorum Pontificum ad vicarios per Illyriam alisque episcopos Collectio Thessalonicensis ad fidem Cod. Vat. Lat. 5751*, Roma 1937.

34 F. CORDIGNANO, *Antichi monasteri benedettini e loro benemerienze sociali in Albania*, in «La Civiltà Cattolica», vol. II, (1929), p. 399-413.

Romës nder ato vise»³⁵.

Kjo lidhje e ngushtë mes Krishterimit perëndimor dhe trojeve tona, kaloi nëpërmjet ngushticave të shumta gjatë historisë pa pasur kurrë një shkëputje të plotë. Në këtë pikëpamje, kjo lidhje mes krishterimit perëndimor dhe trojeve tona nuk u shkëput as atëherë kur Perandoria Romake u nda në perandorinë e Lindjes dhe të Perëndimit (395), as kur Ipeshkvia e Prevalitanës, së bashku me Epirin e Vjetër dhe Epirin e Ri (535) u drejtuan prej Justinianës së Parë, (kryeqendër e rreptë e krishterimit të Lindjes), as atëherë kur Leon Izauriku (732) i ndau trojet tona, dhe Italinë e jugut prej kishës së Romës duke i vendosur nën drejtimin e Konstandinopojës, kryeqendrës së krishterimit lindor. Po ashtu kjo lidhje e ngushtë, mes krishterimit perëndimor në trojet tona u mbajt edhe në kohën kur (1054) ndarja mes dy qendrave (Romës dhe Konstandinopojës) u krye në mënyrë përfundimtare; as atëherë kur u themelua kisha autoqefale Serbe (1219)³⁶. Në fakt kushdo mund të vërtetojë dhe të kuptojë lehtësisht se drejtuesit e Krishterimit Latin, ishin gjithmonë edhe mbrojtës të kombit tonë. Këtë fakt historik e pohon edhe fort mendjendrituri Fan S. Noli kur pohon se: «në pikëpamjen fetare Shqipëria ka qënë e lidhur me Romën që nga shekulli i parë pas Krishtit. Feja e Krishterë u përhap në Shqipëri prej misionarësh të Romës, si kundër provohet nga termat kishtarë, të cilat rrjedhin nga latinishtja. Si një pjesë e Ilirisë, Shqipëria ishte nën juridiktën (drejtimin) e papës deri më 734, kur Perandori i Bizantit Leon I Isvari e çkputi nga Roma dhe ja fali Patrikut të Stamollit. Në periudhën e gjatë të dominatave bizantine, bullgare dhe sërbe, shumë prej Shqiptarëve u kthyen në orthodoksë, veçanarisht në çipat e kufirëve, si nga Janina gjer në Vlorë, nga Ohri gjer në Krujë, dhe nga Shkodra gjerë në Tivar. Po ardhja e kryqësorve katolikë, dhe dominata veneciane dhe neapolitane e ndryshuan fare situatën. Që atëherë katolikizma nisi të ringjallet edhe të përhapet në Shqipëri si një protest kundër zotërimit bizantin edhe sërë»³⁷. Po ashtu eruditi F. Noli pohon edhe se: në krye të shekullit pesëmbëdhjetë Shqipëria ishte pothuaj plotërisht katolike, me nja tetëmbëdhjetë peshkopata të ritit latin. Në këto duhen shtuar edhe disa peshkopata uniata*** të ritit oriental orthodoks, të lidhura me papën»³⁸. Në lidhje me këtë pohim, është fort e rëndësishme që të mbahen në konsideratë edhe kontributet e shumë studiuesve të tjerë³⁹. Fort me rëndësi janë edhe informacionet që Noli na

35 M. SIRDANI, *Vepra atdhetare e françeskanëve*, në «Hylli i Dritës», n. 12, (1940), f. 570-571.

36 A. PALMIERI, *L'ortodossia Serba: Le origini del cristianesimo serbo e le fasi storiche della Chiesa serba*, in «Vita e Pensiero», Vol. 62, Milano 1913, p.176-190.

37 F.S. NOLI, *Shkrime Historike*, Vepra. 4, Tiranë 1989, f. 490.

38 *Idem*.

39 L. TACCHELLA, *Le antiche sedi episcopali latine, greche e bulgare dell'Albania etnica*

jep për parinë e trojeve të Arbnit⁴⁰, sepse dokumentet e kohës, pohojnë po të njëjtën gjë⁴¹. Ai shprehet se: «Sa për kapedanët edhe bajraktarët, këta ishin kthyer katolikë të gjithë njëri pas tjetrit, [...]. Thopiat e Krujës përmenden si katolikë më 1208; Muzhaqët* e Myzeqesë në 1318; Zënëbishët e Gjirokastrës, Muzarakët** e Çamërisë, dhe Shpatët e Nartës më 1354; Balshët e Shkodrës më 1369; Dukagjinët më 1400; Kastriotët më 1407; Altisferët e Danjës më 1414. Kështu kalothikizma nga njëra anë i jipte Shqipërisë bashkimin që i mungonte si shtet, dhe nga ana tjetër e lithte me botën e krishterë europiane»⁴². Këto pohime, që Noli i rreshton janë krejtësisht të bazuara në dokumentet e kohës, të arkivave të Venedikut, të Napolit, të Vatikanit dhe të Raguzës etj... Mjafton të kujtojmë punën e gjigandit të historisë e të historiografisë sonë Zef Valentinit. Në mënyrë të veçantë veprën monumentale dokumentare prej 25 vëllimesh *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV* (Palermo-Milano-Munchen 1963-1979). Po aq me rëndësi edhe vepra tjetër dokumentare prej dy vëllimesh e studiuesit të spikatur, A. Milan Šyfflay, që në bashkëpunim me Ludwig von Thallóczy e Konstantin Jireček publikuan veprën e pazëvendësueshme *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia* (Wien 1913-1918). Studiuesit që marrin përsipër të flasin për figurën e Heroit kombëtar, duhet të jenë njohës të mirë të këtyre burime arkivore, pasi janë burime të dorës së parë⁴³.

e della Macedonia, Milano 1990; L. TACCHELLA, *Il Cattolicesimo in Albania nei secoli XVII e XVIII: dalle visite ad limina Apostolorum e dai processi concistoriali*, Verona 1984; L. TACCHELLA, *Giorgio Castriota Scanderbeg e i Romani Pontefici nel sec. XV*. Verona 1987.

- 40 «Shteti i parë shqiptar që mund të quhet i tillë është Principata e Arbnit me kryeqendër Krujën. Arkontët e tij ose princat Progon (1190-1199), i biri i tij Gjon (1199-1208) dhe vllau i tij Dhimitri (1208-1216) u bënë të pamvarun tue u bënë zotna të teritorit midis Lezhës, Durrsit e Ohrit. Edhe despotati fqinj i Epirti ishte një principatë shqiptare. Përgjatë shekujve XIII-XIV duken emnat e shpijave kryesore feudale shqiptare siç janë të Arianitve, Muzakajve, Kastriotve, Shpatajve, Topiajve, Dukagjinve, Skurrajve etj. Me 21 shkurt 1272, Karli Anzhu e shpalli vetën Rex Albaniae dhe bregdetin e përfshimë midis Durrsit, Beratit dhe Vlorës e quajti Regnum Albaniae». (V. MALAJ, *Kuvendi i Arbnit 1703*, f. 90)
- 41 A. VACCARO, *I rapporti politico-militari tra le due sponde adriatiche nei tentativi di dominio dell'Albania medievale* (secoli XI-XIV) in «Studi sull'Oriente Cristiano», 10/1, Roma 2006, f. 13-71.
- 42 F.S. NOLI, *Shkrime Historike*, f. 491.
- 43 Para këtyre fakteve historike të bazuara në dokumentet të dorës së parë të asaj kohe, disa "pseudo intelektualë (që paraqiten edhe si historianë), pedanta e mendje shterrun që nën çarçafin e 'mitizimit ose të çmitizmit' të historisë sonë të lavdishme, e të heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastriotit, mundohen me mbulue varfërinë e injorancës së tyre, për interesa të kush e di se kuj. E kam fjalën për krejt ata pseudo intelektualë e historianë, që u munduen me çoroditë mëndjen e shqiptarit rreth figurës ma të ndritun të kombit Shqiptarë; e të cillët paraqiten në ekrane televizionesh e faqe

III. Katoliçizmi dhe ruajtja e identitetit kombëtar

Pra duke u mbështetur vetëm në faktet historike mund të pohojmë lehtësisht se krishterimi në trojet tona e ruajti gjithmonë karakterin latino-perëndimor. Po ashtu mund të shtojmë lehtësisht se krishterimi latin dhe kombi shqiptar shpëtuan njëri-tjetrin, në trojet tona⁴⁴. Në të njëjtën mënyrë shprehet edhe eruditi Padre Sirdani: «Shqyphtarvet s’u kishte mbetë atëherë shteg tjetër për me shpetue kombëtarisht veç me u strukë nen hije të kishës katolike, tue kjënë se kryetarët e shteteve të syprithânuna e perdorojshin fën për me njiqpernjisue Shqyphtarët fetarisht e kombëtarisht me kombin e vet. Ndoshti ká me i u dukë ndokujë i tepruem ky pohim i yni, por e verteta ást se, fati i katoliçizmit në Shqypni lidhë në një mënyrë aq të çuditshme me at të kombit t’ynë, sa rrethanat bânë qí kisha katolike të njihej de facto kisha kombëtare e jona, e feja katolike, feja e Shqyphtarvet. Historikisht ást e pamohueshme se kurë kje në pupa feja katolike në Shqypni, në pupa kje edhe kombi shqyptar»⁴⁵

Pak më lart kam theksuar se në trojet tona, doli gjithmonë fitimtare për të mirën e kombit e trojeve tona “lidhshmëria e pazgjidhshme mes krishterimit perëndimor dhe popullsisë së trojeve tona, po ashtu kam theksuar se “litari i kësaj lidhje të pazgjidhshme mes krishterimit perëndimor dhe popullsisë së trojeve tona ishin benediktinët, kjo barrë do të bjerë mbi shpatullat e rregulltarëve Françeskanë⁴⁶. Në gjysmën e dytë

gazetash me ‘paftyresinë (e tyne) me shumë ftyra, për të pafundmen here. Ashtu, këta mendjeshterrun u munduen të bajn edhe në këtë 550-vjetor të heroit kombtar të kombit tonë. Prej ktyre pseudo intelektualve mendjeshterrun, jam i sigurt se në mendjen e shqiptarve nuk ka me u ngulitë asgja tjetër vetëm injoranca dhe “paftyresia e tyne me shumë ftyra”. Sepse mbarë populli shqiptar ku do që ndodhet është më i bashkuar se kurrë, më i ndritur se kurrë, dhe më me vullnet se asnjëherë në histori, për të ruajtur vlerat e figurave kombëtare, e po ashtu për të kthyer një herë e mirë shikimin tonë drejt Perëndimit. Jam i sigurt se asnjë demagogji Ruso-Turke, që punon për shkatërrimin e identitetit tonë kombëtar, kulturor, ekonomik nuk do t’ia dalë që ta bind Shqiptarin për ta kthyer shikimin drejt Lindjes. Në fakt edhe pse për shumë shekuj trojet tona ishin nën sundimin e Lindjes, asnjëherë nuk mundi, asnjë system, të shuaj plotësisht lidhjen me kulturën perëndimore. Falë kësaj lidhje me Perëndimin që u ruajt gjatë shekujsh, me mundin e sakrificën e papërshkrueshme të shumë françeskanëve e po ashtu të krejt traditës së krishterë katolike sot kemi gjuhën, kemi kombin, kemi traditat tona, të cilat duhet gjithmonë t’i ruajmë me mençuri.

44 «Prandaj, mbrojtja e krishtënitimit, në mënyrë të tërthortë, shkonte tue marrë kuptim politik në sa u shndrronte në mbrojtje të pamvarsisë shpirtnore të popullit kundra pushtuesit» (V. MALAJ, *Kuvendi i Arbnit*, f. 88)

45 M. SIRDANI, *Vepra atdhetare e françeskanëve*, në «Hylli i Dritës», n. 12, (1940), f. 573-574.

46 M. F. DI MICELI, *Francescani in Albania* in, «Atti del Convegno Internazionale di Studi Venezia, 13-14 novembre 2009. I Francescani nella storia dei popoli balcanici nell’VIII centenario della fondazione dell’Ordine», a cura di Viviana Nosilia e Marco Scarpa, Venezia 2011, f. 28-36.

të shekullit XIII kjo detyrë, kjo barrë, ky kryq, u ngarkue, mbi shpatullat e françeskanëve, (edhe të Domenikanëve), të cilët me dinjitet të madh, e mbartën mbi shpatullat e tyre këtë përgjegjësi, për tetë shekuj me radhë. Eruditi shqiptar patër Marin Sirdani shprehet se: «Historija na dishmon se nuk u bâ një levizje kombëtare në Shqypni, në daç me pendë po edhe me armë, ku Françeskani mos të mîrrte pjesë aktive per djeri ku këto lëvizje mund të perkojshin me program të jetës e të historis së tij. Këta ndermjetsojn me pajtue e me lidhë princat shqyphtarë me shoqishojn e me shtete të hueja, këta marrin pjesë direkte nder çashtje shoqnore e politike per mirëvojtjen e kombit shqyphtar në pershkimin e sa shekujve. Prandej një histori e pa-anëshme e Shqypnis nuk ka me mujtë kurr me e bâ në sedije djersen, mundin e gjakun qi i u desht birvet të këtij Urdhni me derdhë per me i sjellë vedit aureolen e lumnis në Shqypni»⁴⁷.

Nuk kaloi shumë kohë mbas ardhjes së Françeskanëve (1248) dhe trojet tonado t'imbulton te reja e zezë e ardhur prej Azisë, (1389), për të shkatërruar gjithçka që ishte Shqiptare⁴⁸. Françeskanët të vetmit nuk i braktisën këto troje por me një kurajo të jashtëzakonshme e të lidhur ngushtë me popullin tonë, i bënë ballë pushtuesit të Azisë, - njërit prej armiqve më monstruozë që kishte shkelur në këto troje. Në fakt, gjithë Ballkani pësoi një trishtim të jashtëzakonshëm nga kërcënimet e njëres prej fuqive më të mëdha të asaj kohe siç ishte perandoria osmane. Një tjetër autor françeskan patër Antonin Fishta, na e përshkruan kështu punën e françeskanëve: «Në kohë kaq kritike kërcënimet e anmikut ishin përnjimend të mndershme, rreziku i Atdheut e i Fës u shtrohej Françeskanëve për herë e mâ teper edhe mâ i mjerueshem perpara sÿsh: me gjithkta, tuj ndjekë shembullin e një Shë Njon Kapistranit, Françeskan, qi, tuj prî vetë ushtrisë me një çetë të panumër edhe Françeskajsh tjerë per rreth vedit, qindrote i patrandshëm kundra anmikut të përgjithtë për nën flamurë të fatosit hungares Huniadit, e nën atë të Kristiqit mretit të Bosnjes, edhe Françeskajt e Shqypnis, mbledh tok per rreth Gjergj Kastriotit, rreth Skanderbegut, [...], lypshin ndimen e Papës e të Princave të krishtën, tuj u paraqitë rrezikun e madh qi i kercnohej Europës e marë krishtënimit»⁴⁹.

IV. Françeskanët dhe Skënderbeu

Situata politike e gjysmës së dytë të shekullit XIV^{të}, sjellë faktorë të ndryshëm të cilët do jenë fortë të favorshme për pushtuesit e rinjë në Ballkan⁵⁰. Me ardhjen e pushtuesve të Azisë, Benediktinët e Domenikanët, e

47 M. SIRDANI, *Vepra atdhetare e françeskanëve*, në «Hylli i Dritës», n. 12, (1940), f. 569.

48 CH. HOPF, *Chroniques Gréco-Romanes*, Berlin 1873, f. 276.

49 A. FISHTA, *Skanderbegu e Françeskaj*, në «Hylli i Dritës», n. 7-8, (1930), f. 374-376.

50 «Edhe mbreti i fuqishëm serb Stefan Dushani mori me 1346 titullin Car i Serbëve, i Grekëve dhe i Shqiptarëve. Ma vonë, dinastia e re sllavo-shqiptare, ajo e Balshajve,

braktisën vendin tonë. Në fushën e betejës mbetën vetëm Françeskanët, të cilët e kishin fort për zemër fatin e popullit shqiptar. Françeskanët, (po ashtu i gjithë kleri katolik), në kohë e Skënderbeut patën vertetë një rëndësi të veçant, si në aspektin shpirtërorë, po aq edhe në aspektin socialo-politik⁵¹. Ata edhe pse keqtrajtoheshin, vriteshin, u shkatërroheshin vendbanimet e tyre, ose dëboheshin krejtësisht prej vendit, gjithmonë e gjetën mundësinë të përballonin me dinjitet çdo lloj mundimi e sakrifice, sepse e deshtën vendin, më shumë se vetë jetët e tyre. Jam krejtësisht i bindur se sakrificat e vuajtjet që pësoi populli i trojeve tona, e me ta edhe françeskanët, gjatë pushtimit e sundimit osman, s'ka njeri që mund të marrë guximin t'i përshkruaj. Jo se nuk ka fakte historike e dokumente ku të bazohemi, por sigurisht se do të ishte vërtet e vështirë të besohej, gjithë ajo torturë, gjithë ai mjerim, gjithë ai gjak, që u derdh në trojet tonë si në popull si në françeskanë të cilët kurrë s'e braktisën, nuk e lëshuan njëri-tjetrin, as Frati Shqiptarin e as Shqiptari Fratin. Jam i bindur se vetëm vargjet poetike munden sadopak të përshkruajnë terrorin, dhunimin, gjakun, sakrificat, që u kryen në trojet tona në mënyrë të pareshtur, gjatë pesë shekujve. Prandaj, duke mos dashur të pezmatoj mendjen e lexuesit me barbarizma, po thërrasim në ndihmë, shpirtin e poetit shqiptar dhe françeskan Gjergj Fishta, i cili në vargje poetike na e përshkruan kështu:

Ngusht pat ra dikuer Shqyptari,⁵²
 Kure, msy Turku pre' Anadollit,
 Vendin t'one po e ndizte zhari,
 Zierte gjinden gjâs e trollit,
 E - si koha atbotë qi e barte -
 Vritte e pritte e m' konop varte
 Gjindja trême pre' atij sikletit
 Sidomos t' parë e zotnî-
 Ngarkuen rraqet e shpinës s' detit
 Mueren hiken ví e ví,
 E mas deket t' Skanderbeut,
 Hiken vetë herojt e Atdheut.

shtini në dorë Shkodrën, Vlonën, Beratin e Gjirokastrën. Ndërkohë, feudalë të tjerë shqiptarë shpallën pamvarsinë e tyne. Venediku shtoi zotnimet e veta përtej detit tue marrë me 1932 Durrsin, një vjet mbas Krujën; kurse në fillimet e Katërqindshit, Vlonën me territoret e tjera të lëshueme prej Balshajvet, nga Tivari deri në grykat e Kototrrit» (V. MALAJ, *Kuvendi i Arbnit*, f. 90).

51 A. NDRECA, *Lettere di missionari francescani dall'Albania dell'Ottocento*, in «Atti del convegno internazionale. *L'Albania nell'Archivio di Propaganda fide*, Vaticano, 26-27 ottobre 2015», a cura di A. Ndreca, Roma 2017, f. 308.

52 GJ. FISHTA, *Per meshë të parë të dy Françeskanëve të ri*, në «Zani i Shna Ndout» (1930), n. 7, f. 101.

Vetem Frati vendit s' luejti,
 N' ditë të vshtirë s' u nda Shqypetarvet;
 Fén e besen n' Shqypní i ruejti,
 Ruejti gjuhe e doke t' t' Parvet,
 Pesqind vjet aj t'u perlá
 Kndej me Turk e andej me Shkjá.

Theksoj se françeskanëve kudo që u vendosën, nuk u mungoi kurrë zelli që t'i shërbejnë me shumë pasion dhe përvujtni, kombit tonë. Vërtet e kryen misionin e tyre si predikues, si mësues, si prijës, duke u bërë model të atdhetarisë, e martirë të fesë e të kombit. «Si rojssa besnikë të traditave të lumnueshme t' Urdhnit të vet, këta i u gjeten ndimë popullit shqyptár në çëdo kohë e në çëdo rasë. Na i shohim djeri n'ato kohë prove kurë Turku me ûnë në njanen dorë e me shpatë të pergjakun në tjetren po pershkojte anakand Ballkanín. Po, edhe atëherë na i shohim këta të vetnuem prej rregulltarve t'urdhnave tjerë ke bâhen sý per të verbtin e kambë per të shkeptin, e qindrojn vllá e shoq i padám i popullit shqyptár tue perzie me të lodët e dnesët, e avullin e gjakut, qi me shumicë derdhej prej dejve çilë prej shpatës anmike per ngadhnjim të fés, per lírí t'atdheut»⁵³

Po ashtu, duke shqyrtuar dokumentet e kohës, mund të pohojmë lehtësisht se françeskanëve u ishte besuar prej autoritetit më të lartë të krishterimit latin, përballja me dhunën më mizore që perandoria osmane po i shkaktonte popullit të trojeve tona. Patër Marin Sirdani pohon se: «Po, per fat të mirë, kishte ardhë edhe një herë koha t'a diftojshin Shqypetarët vedin. Me Skanderbegun në krye, i cili ishte "Prodhimi mâ hyjnuer i racës shqiptare", e qi "historija e çëdo kohe vishtirë se e tregojte një kreshnik qi t'i kishte permledhë në veti cilti aq të mëdhá shpirti e korpi". Shqyptari e ndiejte vedin mâ shqyptár e mâ katolik se kurrë, e "dukej si me pasë këthye kohët e lumnueshme të Lekës e të Pirrit»⁵⁴. Përkrah këtij gjigandi, këtij kolosi, mbrojtësi fort të ndritur të trojeve shqiptare, mbrojtës i kulturës e i traditave, e mbi të gjitha kolonë e pathyeshme e bashkimit dhe e lirisë së popullit shqiptar, u rreshtuan edhe françeskanët të cilët e kishin fort për zemër fatin e popullit e të vendit tonë. «E me të vërtetë na i shohim se ku së vedi, ku drejtue prej eprorve të vet, bâjn vendime mbi mjete qi do t'u perdorojshin e mbi fuqi qi do të shtëhej ne veprim per qindresë. Mandej lypin ndima, mbledhin ushtarë, u apin zëmer luftarvet, e pa kursye vedin, lshohen me turr ku lufta ishte mâ e terbueme, ku rreziku ishte mâ i madh. Por, megjithkëta veprimtaria e tyne dishmohet sidomos prej faktit, se këta janë qi mâ së forti ndermjetsojn te Papët e Kryetarët e shteteve në dobí

53 M. SIRDANI, *Vepra atdhetare e françeskanëve*, në «Hylli i Dritës», n. 12, (1940), f. 568.

54 M. SIRDANI, *Vepra atdhetare e françeskanëve*, në «Hylli i Dritës», n. 12, (1940), f. 582-583.

të popullit shqiptar, këta dergohen prej Papve Delegeten e Nunca në dhën t'onë»⁵⁵

Në këtë periudhë një ndër çështjet serioze për krejt Perëndimin ishte problemi i perandorisë osmane, e cila kërkonte pushtimin e Romës. Për këtë arsye papët e Romës, të cilët konsideroheshin si monarkët më të rëndësishëm të Perëndimit, kërkonin që të pengohej me çdo kusht, kjo dëshirë e sundimtarëve osmanë.

Nuk kishte si të mos ndodhte, që edhe pranë Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, të mos ishte prania e françeskanëve, të cilët mbi të gjitha duhej, që të ngushëllonin e po ashtu edhe të nxisnin të krishterët për t'iu gjendur në ndihmë Heroit e kreshnikut legjendar të Shqiptarëve. Lehtësisht, dhe fort mirë të dokumentuara ka informacione të bollshme që tregojnë se edhe pranë Heroit tonë ishin shumë françeskanë që kryenin detyra të ndryshme në shërbim të Heroit tonë kombëtar, për të mirën e vendit. Në shekullin e kaluar, me rastin e përkujtimit të 500-vjetorit të heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu studiuesi dhe arkivist i famë europian dhe njohës i spikatur i arkivave të Vatikanit, po ashtu edhe njohës i shkëlqyeshëm i françeskanizmit në Ballkan, patër Bazilio Pandžić (1918-2011), përpunoi një studim shumë të shkurtër por me vlera shkencore të konsiderueshme me temë "Françeskanët në shërbim të Shqipërisë në kohën e Skënderbeut". Ky studim është mjaft me rëndësi, edhe pse i punuar 50 vite më parë, me rastin e festimeve të 500-vjetorit të Gjergj Kastriotit Skënderbeu, sjell informacione të bollshme për rolin e françeskanëve në kohën e Skënderbeut⁵⁶. Për arsye të kompetencës së autorit në fjalë ky studim është një pikënisje e mirë për të trajtuar temën në fjalë. Prandaj, duke u bazuar në këtë studim të padre Bazilios, po paraqesim shkurtimisht disa prej atyre françeskanëve që vetë autori na i përshkruan.

Autori në fjalë, duke e trajtuar këtë çështje, vë në dukje se një ndër figurat e para dhe të ndritura të françeskanëve që ushtruan shërbim diplomatik pranë Skënderbeut ishte fra Antonio da Napoli (ose me ndonjë mbiemër tjetër si Giovinazzo, ose Fra Antonius de Neapoli alias de Alberto)⁵⁷, i cili gjatë papatit të Eugjenit të IV (1383-1447), ushtronte shërbim diplomatik si ambasador i Raguzës⁵⁸. Ndërsa nga papa Nikolla V, (1397-1455) me breve

55 *Ibidem*, f. 583.

56 B. PANDŽIĆ, *I francescani a servizio dell'Albania nell'epoca di Scanderbeg*, (Françeskanët në shërbim të Shqipërisë në epokën e Skënderbeut), në «Qendra Ndërkombëtare për studimet shqiptare pranë Universitetit të Palermos», Palermo 1969, f. 185-188.

57 «Në fakt Antoni prej Olivetos nuk është tjetërkush veçse Fra Antonio prej Napolit, që nën papën Eugjenin IV ishte nunc papnor në Raguzë nga 1443 deri në 1447. Në dokumentet e Raguzës quhet edhe Fra Antonio da Giovinazzo (Juvenacii), 46 ndërsa një dokument tjetër e quan Fra Antonius de Neapoli alias de Alberto» (B. PANDŽIĆ, *I francescani a servizio dell'Albania nell'epoca di Scanderbeg*, f.185).

58 «Mbase Fra Antonio i mori në Raguzë letrat papnore. Faktikisht në muajin korrik 1447

të quajtur “Cum te ad partes” më 20 qershor 1447, ngarkohet me detyrën si ambasador, që të ushtronte misionin e tij pranë heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Detyrat kryesore (simbas letrës papnore), të Fra Antonit, ishin s’pari të kërkonte ndihma, në mbështetje të luftës kundër turqve, të udhëhequr prej Gjergj Kastriotit; së bashku me këtë detyrë iu besuan edhe shumë shërbime të tjera që do t’i ushtronte në emër të Selisë së Shenjtë pranë besimtarëve që do të merrnin pjesë në luftë. Pra ata që do të luftonin përkrah Gjergj Kastriotit liroheshin prej censurave, (edhe prej atyre që i ishin rezervuar vetëm Selisë së Shenjtë), e po ashtu kishin dhe indulgjencën e plotë. Vetëm një vit më vonë, (9 janar 1448) papa Nikolla V e zgjeron edhe më shumë hapësirën gjeografike në të cilën Fra Antonio da Napoli, do të vepronte, për të zgjidhur konflikte dhe për të shuar vrasjet në Bosnje, Kroaci, Dalmaci dhe Rashë.

Duhet të kujtojmë se pjesë e familjes françeskane ishin edhe shumë bij të trojeve tona që e kishin përqafuar rregullën e Shën Françeskut të Asizit⁵⁹, të cilët luajtën një rol të pazëvendësueshëm për të mirën e vendit tonë nën binomin “fe e atdhe”⁶⁰. Në fakt shpesh ndodhë që autoriteti më i lartë kishtar Selia e Shenjtë, fretërit e këtyre trojeve t’i emërojnë në detyra të rangut të lartë në shërbime diplomatike për krejt Ballkanin, si në rastin e fra Eugen Sumes⁶¹. «Prap Nikolla V me Vulen e vet “Dum salubria” çpallë me 20... 1451 ëmnojte per Shqypni, Rashje e Bullgarí si nunc e Komisár Āpostolík e Invízítuer të Pergjíthtë: Françeskanin shqyptár Eugen Sumen, rregulltár në shêj per zéll, urti e dije. Misjoni i tij ishte me forcue të krishtënët në fé e me i xé në luften kundra Turkut»⁶². Duhet të kujtojmë se Fra Eugen Suma, duhet të ketë qenë pjesëtar i të ashtuquajturës Kustodie të Durrësit që u themelua prej papës Bonifaci IX (1350-1404), më 13 dhjetor 1402, i cili i ndau katër kuvendet e françeskanëve që ndodheshin në pjesën lindore të Dalmacisë, (kuvendet e Tivarit, Ulqinit, Lezhës dhe Durrësit) dhe formoi kustodien e Durrësit.

gjendej në atë qytet, dhe me gjasë ia çoi menjëherë Skënderbeut. Në të vërtetë në muajin dhjetor të 1447 e gjejmë në mbretininë e Napolit, ku kishte shkuar si i dërguari i Skënderbeut për t’i kërkuar ndihmë mbretit Alfonsi V, kryesisht anije (trirrëmshe)», (B. PANDŽIĆ, *I francescani a servizio dell’Albania nell’epoca di Scanderbeg*, f. 186).

59 «Pernji qi Françeskant kishin ngulë në tokë shqyptare, numri i tyre shkoi tue u shtue perherë mâ teper, aq sa, jo vetem kuvendet e Shqypnis, por edhe ato të Dalmacis e të Puljes ishin mbushë me Françeskan shqyptarë. Dr. M. Šufflay, në “Forschungen”, tue folë per Raguzë, thotë se që prej vjetës 1340 ishte mbushë me meshtarë e rregulltarë Domenikan e Françeskan shqyptarë» M. SIRDANI, *Të venduemt e Françeskanëve neper vise të ndryshme të Shqypnis*, Prishtinë 2002.

60 M. SIRDANI, *Françeskanët në Shqypni dhe shqyptarët katolikë në lamë t’ardhetarisë*, Prishtinë 2002, f. 66-75.

61 D. FARLATI- I. COLETI, *Illyrici Sacri, Ecclesia Diocletana*, t. VII, Venetiis 1817, f. 90-92.

62 M. SIRDANI, *Vepra atdhetare e françeskanëve*, në «Hylli i Dritës», n. 12, (1940), f. 584.

«Fra Eugen Suma sigurisht që jetonte në njërin nga katër kuvendet e lartpërmendura, dhe ushtronte shërbimin e tij apostolik. Në ndonjërin prej vizitave të tij në Romë, i paraqiti një relacion shterues mbi gjendjen fetare, dhe në veçanti të Urdhrit françeskan në ato vise, papë Nikollës V, i cili më 21 shtator 1451 e emëroi ambasador dhe prijës apostolik në Shqipëri, Bullgari dhe Rashë. Për çështjet e Urdhrit, papa i dha edhe të drejtën që të kryente edhe shërbimin si Ministër për kustodien e Durrësit. [...] I ngarkuar me këtë mision dhe me këto detyra të mëdha fra Eugeni u kthye në Shqipëri që të vijonte veprimtarinë e tij apostolike»⁶³.

Në këtë periudhë faktikisht, papa Nikolla V, në veprimtarinë e tij antiturke, u angazhua në maksimum që të bashkonte shtetet e krishtera për dëbimin e Turqve, bashkim që në fakt nuk u arrit dhe si pasojë erdhi rënia e Konstandinopojës (29 maj 1453) në duart e osmanëve, dhe gjatë jetës së vetë papa Nikolla V nuk arriti që t'i shihte shtetet e krishtera të bashkuara për këtë qëllim.

Si pasardhës i Nikollës V erdhi papa Kalisti III (1378-1458)⁶⁴ i cili vazhdoi në të njëjtën linjë të paraardhësve, të tij, duke e konsideruar rrezikun osman si problemin më të madh të papnisë së tij. Në fakt, para së gjithash papa Kalisti, më shumë se askush, u mundua me të gjitha forcat që të bashkonte krejt Europën e krishterë për të ndalur turrin e pushtuesve osmanë në Europë, si dhe dëbimin e tyre prej Tokës së Shenjtë. Papa Kalisti në veprimin e tij antiturk, përveç idesë së bashkimit të shteteve të krishtera, pra në fushën diplomatike, ndërmori edhe një nismë mbarë popullore, në mënyrë që të kuptohej sa më mirë domosdoshmëria e mbrojtjes nëpërmjet një kryqëzate sa më gjithpërfshirëse.

Në këtë angazhim që kishte marrë papa Kalisti, u besoi françeskanëve detyra diplomatike pranë prijsave të Europës, e po ashtu u besoi edhe nismën mbarëpopullore të mbrojtjes nëpërmjet një kryqëzate. Në fakt, françeskanët, në shekullin XV, (shekull ky i njohur edhe si shekulli i Skënderbeut), janë të dalluar, e fort mirë të njohur, për zellin e flaktë të tyre ndaj krishterimit perëndimor. Prandaj edhe, papët, duke dashur që të zgjidhnin probleme të ndryshme me të cilat po përballlej krishterimi në Perëndim, përdorën shumë mendje të ndritura të Urdhrit. Mjafton të kujtojmë figura si Shën Bernardinin nga Siena (1380-1444), Shën Giovanni Capestrano (1386-1456), Shën Jakun nga Marca (1391-1476), e shumë e shumë figura të tjera të ndryshme të cilët u ngarkuan prej papëve të këtij shekulli me përgjegjësi fort të mëdha, për të mirën e krishterimit perëndimor⁶⁵. Në fakt Selia e Shenjtë, kishte një besim të madh në punën e

63 B. PANDŽIĆ, *I francescani a servizio dell'Albania nell'epoca di Scanderbeg*, f. 187).

64 I. PARRINO - G. VALENTINI ED, *Acta Albaniae Vaticana. Res Albaniae saeculorum XIV et XV atque cruciatam spectantia*, Vaticano 1971, 26-646.

65 B. PANDŽIĆ, *I francescani a servizio dell'Albania nell'epoca di Scanderbeg*, f. 188-193.

jashtëzakonshme që françeskanët po bënë kundër pushtimit turk në krejt Ballkanin⁶⁶. Për këtë arsye Françeskanët ishin bërë tashmë pikë referimi për Selinë e Shenjtë si në aspektin kishtar, po ashtu edhe në mbarëvajtjen e gjendjes shoqërore, në përballje me terrorin që ushtronte osmanizmi, në krejt krahinën ballkanike⁶⁷, e në mënyrë të veçantë në trojet tona. Për këtë arsye, në këtë periudhë, atyre iu besoheshin detyrat më të rëndësishme kishtarë, pra si ipeshkvij, ambasadorë, komisarë e delegatë. Në këtë kontekst duhet të shihet gjithë veprimtaria e françeskanëve në krejt krahinat ballkanike, e në mënyrë të veçantë në trojet Arbnore.

Në të njëjtën linjë duhet të shihet edhe gjithë veprimtaria antiturke e papëve të Romës, e në mënyrë të veçantë veprimtaria e françeskanëve në trojet tona, si fryt me vlerë të pazëvendësueshme i papë Kalistit, që ngarkon me përgjegjësi të mëdha për të mirën e vendit tonë françeskanë të shumtë. I pari që papa Kalisti III emëroi si Komisar Apostolik për Shqipërinë, Dalmacinë dhe Bosnjen ishte fra Gjon de Prato, (1452); mandej pesë vjet më vonë (1457), dërgoi edhe një tjetër Françeskan Fra Marjanin prej Sierret, të cilit i duhej të organizonte ndihma ekonomike për mbretin e fundit të Bosnjes Stefano Tommaso (1438-1463), dhe për heroin tonë Gjergj Kastrioti Skandërbeu. «Gjithnji Kalisti III, po në të njëjten vjetë, neper Vulen “Cum te pro nonnullis negotiis” dergojte si Legat të vetin Françeskanin shqyphtar, fra Gjonin prej Shqypniet bashkë me dy freten dalmatin, per t’u dhënë zëmer të krishtenvet me ndjekë sa më me zell veprat fetare, e per me i dhanë fund me Skanderbegun punës per të cilen ishte dergue. Në ket rasë, Fra Gjoní me dy shokët, i prûn Skanderbegut ndimat e mbledhuna nder dhëna të Republikës së Venedikut»⁶⁸. Po ashtu në këtë përmbledhje me të dhëna historike duhet të kujtojmë se françeskanët vazhduan të jepnin kontributin e tyre shumë të vyer edhe nën veprimtarinë antiturke të Enea Silvio Piccolomini, papa Piu II (1458-1464); të papë Palit II (1464-1471)⁶⁹; si dhe

66 A. NAUMOV, *I Balcani e i francescani: un'introduzione*, in, «Atti del Convegno Internazionale di Studi Venezia, 13-14 novembre 2009», Venezia 2011, f VII-XI.

67 A. M. SAMUT, *I francescani nel cuore dell'Impero Ottomano*, «Atti del Convegno Internazionale di Studi Venezia, 13-14 novembre 2009.» f. 1-12.

68 M. SIRDANI, *Françeskanët në Shqypni dhe shqyphtarët katolikë në lamë t'ardhetarisë*, Prishtinë 2002, f. 78.

69 «Gjëjen e mjerë të Shqyphtarve t'asajë kohe kshtu i a kjan Shëjti At Papë Pali II, Filipit Dukës së Burgonjes: “Shqyphtarët disa janë mbetun në luftë dekun, disa rrethue gjithkahë prej mjerimesh. Gjytetet qi parandej ishin per né nji murojë kundra Turkut rán nder duer të tylene. Popujt e aferm, qi banojnë bregun e Adriatikut, tuj pasë para sýsh renimin e plotë, dridhen. Gjithkund frigë, gjithkund vajë, gjithkund dekë e robní kemi para sýsh. Ásht mjerim me ndie, se si áisht çatrafilue gjithshkafja. Nuk mund t'i shofin nieri pá derdhë lot lundrat e ktyne refugjatve qi msýjnë limanet e Italís, familje të zhguluna prej votrave të veta, tuj ndëjë buzës së bregut të detit, çojnë duert kahë qiella, e mbushin dhën me vajë e ankime». (M. SIRDANI, *Françeskanët në Shqypni dhe shqyphtarët katolikë*, Prishtinë 2002, f. 120).

të papë Sikstit IV (1471-1484); të cilët, në veprimtarinë e tyre antiturke ua besuan më së shumti françeskanëve detyrat më të rëndësishme në këtë drejtim. Në fakt, edhe pse burimet historike nuk mungojnë, mendoj se është e pamundur që të përshkruhen sakrificat e jashtëzakonshme që ranë mbi shpatullat e françeskanëve,⁷⁰ për shpëtimin e popullit shqiptar prej robërisë që shkaktoi pushtimi osman⁷¹. «Nji gjâ qi nuk mund të vëhet as në dyshim âsht se Françeskanët me klerin tjetër katolik kjenë ata qi e mbajten popullin shqyptâr aq të lidhun me Skanderbegun, e këtyne mâ fort se tjeterkujë do t'u diehet në kje se kreshniku i ynë u bâ aq i njohtun në boten mbarë»⁷².

Mbasi që trojet e Arbnit u pushtuan prej Turqve⁷³, shumë prej princave e bujarëve shqiptarë, që nuk duruan zgjedhën turke, morën rrugën e mërgimit, duke formuar koloni të ndryshme nëpër shtete të Europës. Ndërsa, pjesa e madhe e populli u shpërnda malesh. Françeskanët, edhe në këtë situatë nuk i braktisën as ata që morën dhenë e as ata që u shpërdanë nëpër male. Ata që morën udhën e mërgimit, si fillim u strehuan edhe nëpër kuvende të ndryshme të françeskanëve, e të rregulltarëve të tjerë, deri në momentin që edhe gjetën mundësinë të stabilizoheshin me familjet e tyre. «Por edhe para e mbas kësajë kohe, në rasa salvimesh, Françeskanët u prîn Shqyptarve e i venduen neper krahina të ndryshme t'Europës.

70 «Origjina aziatike e turqve, ndryshimi i racës, i mendsisë dhe i besimit, mungesa e çdo mirkuptimi midis fitimtarëve dhe të mundunve, i jepte jetës qytetare një shëjë dalluese kaq të thellë sa që do të mbetej e pashlyeshme plotësisht edhe me kalimin e shekujve. Tue ngatrrue ligjin civil me atë fetarë, islami i jepte një pamje kaq sektare çdo shfaqje të jetës sa me krijue një hendek të vertetë midis besimtarëve dhe të pafeve (kaurrave). Tue i bajtë larg rrethit të të zgjedhunve, të përjashtuem nga të gjitha privilegjet që i rezervoheshin muslimanëve, të krishtët (raja) përbaishin një kategori më vete, të një rangut të ulët, me të cilin çdo asimilim ishte i pamundur» (V. MALAJ, *Kuvendi i Arbnit 1703*, f. 113).

71 «Qandrat qi mâ fort i bân qindresë këtyne sulmeve kjenë Shkodra e Krueja. Nder sa heroj t'atynë luftave dahan në shëj edhe dy Françeskaj: Fra Palí prej Matit, e Fra Bartolomeu prej Venedikut, qi ngujue në vjeten 1475 në kështjellín Rozafat me fjalë e me tregim shkojshin tue dhanë zëmer perherë e mâ fort luftarve të rrethuem. Nji ditë prej ditësh, në një të msýme të mnershme, tue u pasë dalë disa Turq me u kapë në njanen anë djeri mbi ledhe të kështjellit, në sa ishin tue ngulë flamujt turq, u turren dy Françeskanët me aq furí, sa u dhanë të shtëmën e i planosen copë e krimë neper shkambíj. Mandej, marrë ata vetë disa flamuj t'anmikut, me trimní të veten u dhanë aq zëmer luftarvet të kështjellit, sa këtyne u duel at ditë me lá lesh n'anmik» (M. SIRDANI, *Kontributi i elementit katolik shqyptâr në lamë t'atdhetaris që prej kohve të vjetra deri në kohen e turqve të rí*, Prishtinë 2002, f. 79).

72 *Ibidem*, f. 78.

73 «Shqipnia, e reduktueme në një provincë otomane, nuk gëzoi për disa shekuj as pamvarsi, as jetë kombtare. Qindra mija shqiptarë emigruen në Republikën e Venedikut, në Mbretërinë e Napolit, në Dalmaci e vënde të tjera, tue kërkue strehim e mbrojtje nga mizoritë turke, ku akoma sot, mbas shekujsh ruejn traditat e veta, veshjet e veta, ritin dhe Gjuhën» (MALAJ V., *Kuvendi i Arbnit*, f. 94)

Kronika e kuvendit të Zaostrogut, dishmon se fretent e atij kuvendi bân me ardhë prej Shqypnîje e me xânë vend nder dhena të Venedikut 4000 familje katolike»⁷⁴. Ndërsa për ata që u shpërdanë nëpër male, Françeskanëve nuk ua bëri zemra që t'i braktisinin, por së bashku me ta u strukën ndër male ndër shpella e shpate malesh, me më të madhen dëshirë që të lehtësonin sadopak dhimbjen dhe torturat e pushtuesve, e mbi të gjitha të ruanin atë linjën e bashkimit të etnisë së Arbnit me krishterimin Latin, që shpëtuan njëra-tjetrën. «Qýsh me ket kohë, qi u shduk të thuesh faret aristokracia e naltë, influenca e kishës u bâ shum e madhe. "Priftent e ipeshkvijt vetë atëherë ishin luftarë të rrebët, qi iu pershtatshin çarkut të vet... Prej maleve të Zetës deri n'Oher e në Himarë shifen prova të qarta të shformimit të fisevet t' organizueme në fuqí hjerarkore shtetnore»⁷⁵ Në fakt lidhja e ngushtë që u ndërthur mes klerit dhe popullit, u bë e mundur që të mbijetonte për gati pesë shekuj, dëshira për liri kombëtare⁷⁶.

V. Mbyllje

Në mbyllje të këtij përshkrimi të shkurtër, dëshiroj të theksoj se Françeskanët dhanë një kontribut fort të vyer për zhvillimin dhe përparimin e fesë katolike, dhe po aq me zell e dashuri, dhanë kontributin e tyre për kulturën kombëtare e gjuhën Shqipe. Françeskanët (e po aq gjithë kleri katolik), u munduan me të gjitha forcat e tyre, për rimëkëmbjen e kombit tonë, duke e udhëhequr dhe frymëzuar drejt qytetërimit të përparuar perëndimor. Në të njëjtën kohë, shprehën gjithmonë një angazhim intelektual të prerë në mbrojtjen e identitetit historik, kulturor dhe moral të Kombit tonë. Françeskanët kanë një kontribut të jashtëzakonshëm për ruajtjen e vlerave morale e kombëtare, qysh kur mbërritën në shekullin XIII (1248), e deri në ditët tona.

Për këtë arsye, mendoj se shteti ynë shqiptar do të shprehte nderim e mirënjohje sikur në këto dy përvjetore, në mbyllje të përkujtimit të 550-vjetorit të Heroit tonë kombëtar, të vlerësohej edhe kontributi që françeskanët kanë dhënë në ruajtjen e vlerave kombëtare gjatë shekujve duke e nderuar institucionin e Provincës Françeskane Shqiptare "Zoja Nunciatë" me udhërin e artë "Nderi i Kombit".

74 M. SIRDANI, *Kontributi i elementit katolik shqyptár*, f. 89.

75 *Ibidem*, f. 121.

76 «Gjatë Shkatrrimit pothuajse total fetar, politik e kulturorë që përjetoi Shqipnia mbas pushtimit otoman, vetëm tradita kishtare mbërriti me u transmetue brezave të ardhshëm kultin e besimit të parve të ripërtrimë dhe të mbrojtunme gjuhën e zemrës e të votrës shtëpijake, lidhja e vetme e fisit të ndamë dhe të shpërndamë, mjeti i vetëm dhe simboli i unitetit etnik. (V. MALAJ, *Kuvendi i Arbnit*, f. 88)

BIBLIOGRAFIA

- CORDIGNANO F., *Antichi monasteri benedettini e loro benemerenze sociali in Albania*, in «La Civiltà Cattolica», vol. II, (1929), p. 399-413.
- DA CIVEZZA M., *Storia universale delle missioni francescane*, Tomo I, Roma 1857.
- DE GUBERNATIS D., *Orbis Seraphicus, de Missionibus Apostolicis Fratrum Minorum ad infideles a Sacra Congregatione de Propaganda Fide dependentibus*, Tomus II, Quaracchi 1886.
- DI MICELI F M., *Francescani in Albania* in, «Atti del Convegno Internazionale di Studi Venezia, 13-14 novembre 2009. I Francescani nella storia dei popoli balcanici nell'VIII centenario della fondazione dell'Ordine. » a cura di Viviana Nosilia e Marco Scarpa, Venezia 2011, f. 28-36.
- DELLA CROCE L., *Registro della Provincia osservante d'Albania, 1720, (regjistri i Provincës oservante të Shqipërisë) f. 265.*
- DUCELLIER A., *La façade maritime de l'Albanie au Moyen Age: Durazzo et Valona du XI^e au XV^e siècle*, Paris 1978.
- FARLATI D-COLETI I., *Illyrici Sacri, Ecclesia Diocletana*, t. VII, Venetiis 1817, f. 90-92.
- FABIANICH D., *Storia dei frati minori dai primordi della loro istituzione in Dalmacia e Bossina*, Vol. II, Zara 1863.
- FISHTA A., *Skanderbegu e Françeskaj*, në «Hylli i Dritës», n. 7-8, (1930), f. 374-376.
- FISHTA A., *Ma i pari Frat në Shqyppni. Êmzot Gjoni prej Plano Karpini*, në «Hylli i Dritës», n. 4, (1930), f. 209-217.
- FISHTA GJ., *Per meshë të parë të dy Françeskanëve të ri*, në «Zani i Shna Ndout» (1930), n. 7 f. 100-103.
- FONDO., *Schizzo storico sull'opera dei Francescani in Albania: (Pro Manuscripto)*, Scutari 1930, (deposito, MISC. 0218 (01).
- GONZAGA F., *De origine seraphicae religionis franciscanae*, Rome 1587.
- LIVERANI F., *Fra G. da Pian di Carpine del contado di Magione viaggiatore e descrittore di Tartaria e Mongolia nel secolo XIII*, Perugia 1876.
- MALAJ V., *Te dhana Albanologjike, Folklor, Bibliografi, Histori, (Dati Albanologjici, Folclore, Bibliogafie, Storia)*, në «Shoqata Gjon Buzuku», Vol. II, Ulqin-Tuz 1999, f. 315-328.
- MALAJ V., *Kuvendi i Arbnit 1703*, Tuz 2017.

- NAUMOV A., *I Balcani e i francescani: un'introduzione*, in, «Atti del Convegno Internazionale di Studi Venezia, 13-14 novembre 2009. I Francescani nella storia dei popoli balcanici nell'VIII centenario della fondazione dell'Ordine» a cura di Viviana Nosilia e Marco Scarpa, Venezia 2011, f. 7-11.
- NDRECA A., *Lettere di missionary francescani dall'Albania dell'Ottocento*, in «Atti del convegno internazionale. *L'Albania nell'Archivio di Propaganda fide*, Vaticano, 26-27 ottobre 2015», a cura di A. Ndreca, Rome 2017, f. 307-325.
- NOLI S F., *Shkrime Historike*, Vepra 4, Tiranë 1989, f. 490.
- GJEÇAJ D., *Shkrime historike, letrare pulicistike*, Vepra I, Shkoder 2012.
- GJURAVÇAJ A., *Sangre Azul*, në «Koha Javore», n. 819, (2018), f. 24-25.
- PALMIERI A., *L'ortodossia Serba: Le origini del cristianesimo serbo e le fasi storiche della Chiesa serba*, in «Vita e Pensiero», Vol. 62, Milano 1913, f.176-190.
- PANDŽIĆ B., *I francescani a servizio dell'Albania nell'epoca di Scanderbeg*, (Francheskanët në shërbim të Shqipërisë në epokën e Skënderbeut), në «Qendra Ndërkombëtare për studimet shqiptare pranë Universitetit të Palermos» Palermo 1969, f. 185-188.
- PARRINO I-VALENTINI G ED., *Acta Albaniae Vaticana. Res Albaniae saeculorum XIV et XV atque cruciatam spectantia*, Vaticano 1971, 26-646.
- HOPF CH., *Chroniques Gréco-Romanes*, Berlin 1873.
- HOXHA G. - PËRZHITA L. - CAVALLINI F., *Monumente Historike të kultit të Krishterë në Dioqezën e Lezhës*, Lezhë 2017.
- SAMUT M A., *I francescani nel cuore dell'Impero Ottomano*, «Atti del Convegno Internazionale di Studi Venezia, 13-14 novembre 2009. I Francescani nella storia dei popoli balcanici nell'VIII centenario della fondazione dell'Ordine.» a cura di Viviana Nosilia e Marco Scarpa, Venezia 2011, f. 1-12.
- SIRDANI M., *Francheskanët në Shqypni dhe shqyphtarët katolikë në lamë t'ardhetarisë*, Prishtinë 2002.
- SIRDANI M., *Vepra atdhetare e francheskanëvet në Shqypni*, në «Hylli i Dritës», n. 12, (1940), f. 582-583.
- SIRDANI M., *Të venduemt e Francheskanëvet neper vise të ndryshme të Shqypnis - 1240-1940*, në «Hylli i Dritës», n. 1-2, (1940), f. 65-83.

- SIRDANI M., *Kontributi i elementit katolik shqyptár në lamë t'atdhetarís që prej kohve të vjetra deri në kohen e turqve të rí*, Prishtinë 2002.
- SPILA B., *Memorie storiche della Provincia Riformata Romana*, Tomo II, Milano 1896, f.302-303.
- SHUFLAJ M., *Serbët deh Shqiptarët*, Tiranë 1926 f. 195.
- TACCHELLA L., *Le antiche sedi episcopali latine, greche e bulgare dell'Albania etnica e della Macedonia*, Milano 1990.
- TACCHELLA L., *Il Cattolicesimo in Albania nei secoli XVII e XVIII: dalle visite ad limina Apostolorum e dai processi concistoriali*, Verona 1984.
- TACCHELLA L., *Giorgio Castriota Scanderbeg e i Romani Pontefici nel sec. XV*, Verona 1987.
- TARAOUCA S K., *Epistularum Romanorum Pontificum ad vicarios per Illyriam alisque episcopos Collectio Thessalonicensis ad fidem Cod. Vat. Lat. 5751*, Roma 1937.
- THALLÓCZY L-JIREČEK C-ŠUFFLAY M., *Acta et diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia II (1344-1406)*, Vienna 1913-1918, (rist. anast., a cura di S. SINANI-M. AHMETI, Tirana-Prishtina 2002.
- XHUFI P., *Dilemat e Arbrit. Studime mbi Shqipërinë mesjetare*, Tiranë 2006, Paris 1978.
- URDHRI I FRETËRVE MINORË., *Nekrologu i Provincës Shqiptare të Zojës Nunciatë, Shkodër* 2001.
- VACCARO A., *I rapporti politico-militari tra le due sponde adriatiche nei tentativi di dominio dell'Albania medievale (secoli XI-XIV)* in «Studi sull'Oriente Cristiano», 10/1, Roma 2006, f.13-71.